



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 425/1 Prot.

Tiranë, më 11 /04/2016

VENDIM

Nr. 13, datë 11 / 4 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "BIRN Albania", ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 425 Prot., datë 06.04.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Bashkia Tiranë me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtarë*".

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën nr.297 Prot., të datës 16.03.2016 ka kërkuar nga Bashkia Tiranë t'i vihet në dispozicion:

1. *Cv-të e administratorëve të përzgjedhur për njësitë administrative të Bashkisë Tiranë.*
2. *Procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së tyre.*

Bashkia Tiranë me shkresën nr.8773/1 Prot., datë 31.03.2016 i ka kthyer përgjigje Qendrës "BIRN Albania" duke argumentuar se informacioni i kërkuar nuk mund t'i vihet në dispozicion pasi konsiderohen të dhëna personale dhe konfidenciale të mbrojtura me ligj.

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga *Autoriteti Publik*, ankuesi pretendon se: "*Bashkia Tiranë, ka shkelur ligjin duke refuzuar një pjesë të kërkesës për informacion si dhe duke konsideruar faktin që ky informacion mund të ofrohet duke fshirë "të dhënat personale" sipas përcaktimit në ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" e duke ofruar "informacionin publik" siç përcaktohet në ligjin "Për të drejtën e informimit", në këto kushte kërkon nga KDIMP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.*

Qendra "BIRN Albania" pretendon se përgjigja e Bashkisë Tiranë nuk është e bazuar në ligj pasi, Bashkia Tiranë duhet ta kishte vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar duke anonimizuar të dhënat personale sipas përcaktimit të ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Pas shqyrtimit të ankesës, si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezultoi se informacioni i kërkuar është informacion publik dhe se argumenti i Bashkisë Tiranë nuk mbështetet në asnjë parashikim ligjor. Në kuptim të nenit 7 pika 1 gërma d), të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", "*të dhënat për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve,*

të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime", duhet të publikohen në programin e transparencës. Ndërsa ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", në nenin 3 të tij ligji, "Përkufizime" parashikon "Të dhëna personale" "është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social".

Për sa më sipër Zyra e Komisionerit vlerëson se Cv-të e administratorëve të përzgjedhur për njësitë administrative të Bashkisë Tiranë si dhe informacioni mbi procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së tyre, janë informacione publike të cilat lidhen ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies së Autoritetit Publik.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "BIRN Albania" ndaj Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative'.

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "BIRN Albania", Nr. 425 Prot., datë 06.04.2016, ndaj Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar brenda datës 18.04.2016.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 11.04.2016.

